

V E N D I M
Nr.453, datë 26.9.1994

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE

Në zbatim të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, ndryshuar me ligjin nr.7785, datë 27.1.1994, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

1. Masa e ndihmës ekonomike të plotë mujore përcaktohet nga këshilli i bashkisë ose komunës, por jo më e vogël se niveli minimal dhe jo më e madhe se niveli maksimal i përcaktuar në nenin 1 të ligjit nr.7785, datë 27.1.1994, dhe i llogaritur sipas pikës 2 të këtij vendimi.

Brenda këtyre kufijve, masa e ndihmës ekonomike të plotë mujore varet nga numri i anëtarëve të familjes, si dhe nga bllokndihma (fondi) i akorduar për t’u përdorur brenda 1 muaji.

2. Për efekt të llogaritjes së masës së ndihmës ekonomike të plotë mujore të çdo familjeje përfituese, merret në konsideratë familja me 5 anëtarë, në të ardhurat totale të së cilës përfshihen:

- të ardhurat nga papunësia të 2 personave;
- kompensimet për persona në ngarkim nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.310, datë 24.7.1992.
- kompensimet për persona në ngarkim si efekt i rritjes së çmimit të bukës, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.274, datë 12.6.1993.

Përjashtimisht, për efekt të llogaritjes së masës së ndihmës ekonomike të plotë mujore për familjen me 1 anëtar merret në konsideratë e ardhura totale e saj, në të cilën përfshihet e ardhura nga papunësia e 1 personi.

3. Masa e ndihmës ekonomike të pjesshme mujore përcaktohet nga këshilli i bashkisë ose komunës si deferencë ndërmjet ndihmës ekonomike të plotë mujore dhe të ardhurave aktuale të familjes, ku përfshihen të gjitha llojet e të ardhurave nga çdo veprimtari ekonomike. Ndihma ekonomike e pjesshme nuk përfitohet, nëse është më e vogël se 10 për qind e masës së plotë të saj.

4. Për përfitimin e ndihmës ekonomike mujore të plotë ose të pjesshme nuk merret parasysh ndarja e familjes, me përjashtim të rasteve kur brenda saj krijohet kurorë e re.

5. Pagesa e ndihmës ekonomike bëhet në bashki dhe komuna nga personeli llogaritar arkëtar i tyre.

6. Ngarkohet Ministria e Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të nxjerrin udhëzimet e nevojshme në zbatim të këtij vendimi.

7. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.622, datë 31.12.1993 “Për dhënie e ndihmës ekonomike”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 nëntor 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi